

TREGUESIT KRYESORË FINANCIARË TË QTATD PËR VITIN 2020

Qendra e Trajnimeve te Administrates Tatimore dhe Doganore (QTATD)ka si objektiv krijimin dhe përmirësimin e njohurive te duhura tek burimet njerëzore të administratave fiskale tatimore dhe doganore, me qëllimin për të arritur synimet e mëposhtme:

- Focimin e kapacitetit institucional të organeve fiskale.
- Të përshpejtojë reformat në vazhdimësi në sektorin fiskal.
- Përmirësimin e kapaciteteve ligjore dhe administrative të organeve fiskale për tu përshtatur, me kërkesat që duhen përmbushur për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

QTATD siguron formimin profesional të administratës tatimore dhe doganore, i cili përfshin trajnimin:

- a) në periudhën e provës;
- b) për zhvillimin e karrierës;
- c) për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës, sipas ligjeve të fushës;
- d) me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta;
- e) për zhvillimin e njohurive profesionale.

QTATD eshte institucion ne varesi te Ministrise se Financave dhe Ekonomise.

QTATD i pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me Udhezimin nr.8 date 09.03.2018 "Per procedurat e pergatitjes, paraqitjes dhe raportimit te pasqyrave financiare vjetore ne njesite e qeverisjes se pergjithshme".

1. Buxheti, plani i shpenzimeve per vitin financiar dhe vitet ne vazhdim

Ne table me poshte paraqitet buxheti i QTATD ne mijera lek per vitin aktual financiar 2020 dhe vitet ne vazhdim 2021 dhe 2022.

P.BUXHETI	L L O G A R I T E				
	600	601	602	606	Totali
Periudha					
Viti 2020	10,285	1,815	5,200	50	17,350
Viti 2021	10,285	1,815	5,200	0	17,300
Viti 2022	10,285	1,815	5,200	0	17,300

2. Raport vjetor per zbatimin e buxhetit dhe anekset

Në mënyrë të detajuar shpenzimet e buxhetuara dhe të realizuara paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Llogari	Zerat e shpenzimeve	Buxheti	Realizimi	Diferenca	Realizimi ne %
600	Pagat dhe perfitimet e punonjesve	10,285,000	6,198,792	(4,086,208)	60%
601	Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	1,815,000	1,023,812	(791,188)	56%
602	Blerje mallra e sherbime te tjera	5,200,000	977,988	(4,222,012)	19%

Llogari	Zerat e shpenzimeve	Buxheti	Realizimi	Diferenca	Realizimi ne %
606	Transferta per buxhetet familjare dhe individet	50,000	50,000	-	100%
Totali i shpenzimeve		17,350,000	8,250,592	(9,099,408)	48%

Për sa i përket shpenzimeve të QTATD-së gjate vitit 2020, janë realizuar në shpenzime paga personeli , shpenzime kontribute sigurime shoqerore dhe shendetesore, shpenzime per blerje mallra dhe sherbime dhe shpenzime per shperblime familjare ne raste fatkeqesie. Keto shpenzime jane bere duke mbajtur parasysh Objektivat e QTATD dhe angazhimet e përcaktuara në Planin Strategjik.

Për vitin 2020 shpenzimet e QTATD jane 48% me te ulta sesa shuma e buxhetuar ku diferenca me e madhe verehet ne shpenzimet e pagave dhe ne blerjet e mallrave e sherbimeve.

Lidhur me të dhënat ne tabelen e mësipërme, sqarojmë se:

- Shpenzimet e personelit jane realizuar 60%, per arsye të mos plotësimit të pozicioneve të punës sipas planifikimit të berë në 2020. Numri i punonjesve ishte buxhetuar ne 9 persona per, nderkohe numri faktit mesatar i punonjesve per 2020 eshte 7 persona. Kjo ndikon si ne shpenzimet e pagave dhe ne kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore.
- Shpenzimet per mallra dhe sherbime janë realizuar në masen 19%. Kjo per faktin se gjate pandemise punonjesit kane pasur mundesine te punojne nga shtepite, fakt qe ka ndikuar ne konsumin e mallrave e sherbimeve. Gjithashtu, numri i trajnimeve te realizuara eshte me i vogel per shkak te pandemise.

3. Dokumentat qe tregojne gjendjen e shlyrjeve te detyrimeve nga subjektet e licensuara

Ne tabelen me poshte paraqiten blerjet e QTATD nga subjekte te licensuara. Keto detyrime jane likuiduar gjate vitit 2020.

Nr.Urdher shpenzim	Furnitori	Data fatures	Vlera	Pershkrimi
24	Euro Office shpk	20.02.2020	102,000	Materiale kancelarie (tonera)
25	Euro Office shpk	20.02.2020	108,000	Materiale kancelarie
59	Hello shpk	25.11.2020	60,000	Shpenzime irembajtje e faqes web
26	Egian Med shpk	25.05.2020	58,824	Blerje materiale per gjendje Covid
27	Farma Net Albania	19.05.2020	72,840	Blerje materiale per gjendje Covid
38	Florfarma shpk	03.07.2020	2,870	Shpenzime dizinfektimi
37	Marvis Kapllani PF	09.07.2020	106,800	Shpenzime riparimi kompjutera dhe printera
	Bashkia e Tiranës	16.06.2020	15,654	Taksa bashkiake
Totali			526,988	